



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 1443 Prot

Vlorë, më: 18.09 2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI I

Datë 09.09.2024 ora: 10:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012. “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.13107 datë 21.08.2024.

Marrin pjesë:

Nën kryetarja e Bashkisë Vlorë-znj. Irena Toshkallari, Nën kryetari i Këshillit Bashkiak-z.Novrus Rokaj, Kryetari i Rajonit 1- Skerdi Hunda, Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj, anetar te keshillit bashkiak, Drejtori i DFKB-Kozma Mali, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, media dhe OJF locale,

(Në takim marrin pjesë më shumë se 17 persona, listeprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Nënkryetarja e Bashkisë Vlorë, znj.Irena Toshkallari: Përshendetje, të gjithëve! Ju falenderoj për pjesëmarrjen. Jemi mbledhur për të prezantuar projekt buxhetin afatmesëm të Bashkisë Vlorë 2025-2027, çfarë ka parashikuar bashkia, projektet dhe investimet që do të realizohen, do diskutojmë mbi kërkesat dhe pyetjet tuaja, parashikimet për vitin 2025

dhe vitin aktual. Dëgjesa do të filloj me fjalën e drejtorit të financës pastaj do të dëgjojmë pyetjet tuaja. Prezent janë edhe drejtorët e administratës për të diskutuar mbi rastet, bëni një kërkesë me shkrim kur problemi kërkon koordinimin e strukturave dhe zyrave të tjera.

Z. Kozma Mali: Përshëndetje. Do prezantoj PBA.

Në lidhje me investimet per 2024 në vazhim dhe 2025 per Rajoni 1 bashkia ka parashikuar rrugën “Donika Kastrioti” ka përfunduar projekti dhe është në proces vlerësimi.

Është blloku i banesave në lagjen Partizani (rruga Tartar Memushi, Fejzi Micolli, Elmaz Deri, Agim Shuku, Dora Distra) ka përfunduar projekti janë tenderuar dhe është në proces vlerësimi. Për 20 ditë maksimumi lidhen kontratat.

Rruga mbas godinës së bashkisë që lidh Karabashin me Lirim dhe një fragment i rrugës Ded Gjon Luli dhe rruga Donika Kastrioti (segmenti 2) janë në proces tenderimi dhe priten të fillojnë punimet.

Është bërë rikonstrukcioni i palestrës në shkollën 4 Heronjtë e cila ka përfunduar projekti por do të hartohet një projekt i ri që do të përfshijë rikonstrukciosnin e shkollës.

Rikonstrukcioni i rrugëve në zonën e ish- Fabrikës së Cimentos është në dy faza implementimi i saj.

Rikonstrukcioni i banesave të komuniteteve të varfra dhe të pafavorizuara ka përfunduar projekti dhe investimi.

Rikonstrukcion i fasadave të objekteve të banimit ndërtuar përpara viteve 90 në rrugën Ali Demi nga FSHZH janë 12 objekte në përfundim të investimit.

Rikonstrukcion i tualeteve të kopshtit nr.5, pranë shkollës Teli Ndini ka përfunduar projekti dhe është në process tenderimi.

Gjithashtu është sistemimi i disa akseve në Lagjen Partizani dhe Karabash nga FSHZH, ka përfunduar investimi.

Dhe investime të tjera të parashikuara nga bashkia.

Jemi në pritje të pyetjeve dhe sygjerimeve tuaja. Cfarë duhet të parashikojmë?

Beqir Haki Mane: Banor në L. Karabash. Jam qytetar i Vlorës dhe banor i Rajonit 1. Përgëzoj administratë dhe kryetarin e bashkisë. Në plan projektin tuaj nuk përmendet kanali që rrezikon Vlorën, kanali i ujrave të bardha, nga liqeni artificial mbi spital dhe poshtë. Të ngrihet një komision me ekspertë dhe specialist, inxhinier të bëjnë vlerësimin, sepse ka rrezik epidemie dhe permbytje dhe është afër AKU. Rrezikohet të mbytet Vlora nga kanali i ujrave të bardha. Kryetari i rajonit është kryetari i bashkisë për ne. Ju se keni parashikuar ne projektbuxhet kanalin. Anullojeni këtë projekt, te vij ne terren inxhinieri ta shikoj gjendjen jo të punoj nga zyra

dhe parashikojeni në projekt kanalin. Duhet qytetarët dhe kryetari I rajonit që të bëhet buxheti. Kërkoni ndihmë nga komuniteti që të pastrohet kanali.

Irena Toshkallari: Ky është një projekt dhe ne po marrim shqetësimet tuaja. Do vij grupi në terren dhe do ta verifikoj.

Zenel Qytetar: Korsia e emergjences të rruga Ali Demi ka pezulluar punën e bizneseve. Jemi me fëmijë të sëmurë, gjobat në korsinë e emergjencës, bizneset në krahun e djathtë rrezikojnë të mbyllën. 1/3 e bizneseve janë jashtë funksionit. Më shumë keni bërë dëm me atë projekt dhe kjo ka kosto politike për ju. Trotuaret e rrugës Ali Demi rregullojini, jam taksapagues për 3 biznese. Sillni ujin, pastroni pucetat, ujrat që rrjedhin nga kodra zbresin në trotuar. Pallati përballë DSHSHS do rikonstruksion, te ish materniteti i vjetër janë shkëputur blloqet e betonit dhe rrezikojnë jetën e njerëzve. E kam thënë të 3 kryetar bashkie dhe nuk e kanë bërë. Pallati 575, kanalet e ujrave të zeza te ndërtuara para viteve 70, duhet investuar ngjitur me lapidarin, kanalizimet, sistemojini.

Irena Toshkallari. Pallati është në fazën e dytë. Duhet të plotësohen standartet për korsine e emergjencës.

Qytetar: Blejmë ujin me lek. Jemi me libreza që në 2004 dhe s'kemi ujë të pijshëm.

Irena Toshkallari: Do organizojmë një takim me dr e ujësjellësit dhe kryetarin e rajonit ta shikojmë kryetari i rajonit e ka përcjellë te emergjencat si shqetësim. Uji i pijshëm dhe kanalizimet janë përgjegjësi e tyre

Qytetar: Kërkesat në bashki nuk plotësohen. Bëni projekt. Mbi spital jemi pa ujë për 10 vjet. Kërko sot e kërko nesër. Uji i shiut nuk pihet. Kinemanë e Ali Demit shikojeni, kanalin para bashkisë që vjen era, mbyllini. Kjo kulla këtu ka 50 vjet me llamarinë, bëni dicka, shtrëngoni punimet. Të hapet rruga. Gjeneri lekët dhe bëni rrugën Karabash. Kemi shumë halle. Te liqeni artificial vendosni stola betoni jo druri se i kanë prishur.

Irena Toshkallari: Bashkia ka bërë investime por duhet dhe përgjegjësia e komunitetit. Godina para bashkisë është e parashikuar 4 ml lek si projekt dhe do mbaroj. Kinemaja te Ali Demi është pronë private. Bashkia e ofron shërbimin e kinemasë në Pallatin e Kulturës.

Nora-Qytetare: Gratë e dhunuara a i ndihmon bashkia? A ka buxhet për ti mbështetur?

Irena Toshkallari: Kemi struktura mbështetëse për gratë e dhunuara. Kemi marveshje me Qendrën Vatra dhe Strehëzën. Kemi programin e bonusit social, kredi të buta me kosto të ulët. Në VKB përcaktohen kriteret favorizuese për gratë dhe ju jepet prioritet. Trokisni në bashki, te zyra e informacionit dhe strukturat përgjegjëse që të përfitoni shërbimin e duhur.

Devoll Lika: Qytetar. Rruga mbas Kuzum Babasë. Firma Duka ka vënë një tubo, që është ngrënë dhe ka 20 vjet që nuk është hequr. Është zënë pjesa e tubos dhe sjell ujin në xhade, do bien

shtëpitë dhe rruga. E dinë të gjithë. I kam kapur të gjithë. S'kam pse të kap kryetarin e bashkisë . 100 shtëpi i ka bllokuar 1 shtëpi. Ku të shkoj? Do hequr kanali i gjithë.

Skerdi Hunda -KR1-e kemi sqaruar me NSHP dhe Ujesjellësin e kemi trajtuar personalisht. Është përcjellë si shqetësim. Është kanal i krijuar nga shtëpitë. Ujrat që kullojnë i shkojnë te shtëpia. E kemi trajtuar dhe do i gjejmë një zgjidhje edhe me banorët e tjerë. Por duhen bërë bashkë në një mendje, zotria dhe ai i shtëpisë dhe NSHP.

Irena Toshkallari: Shikojeni në terren nga java të gjithë bashkë.

Ahmet Rrapaj-Qytetar: Përshendetje. Kam 3 probleme sociale. Banoj në lagjen H.Cakëri, dhe si banor bëj punë sociale. Problem i parë janë ofcinat dhe lavazhot edhe pse i kemi të miqve dhe te shokve, por duam qetësi dhe të kemi mundësi të lëvizim pa pengesa në rrugët e lagjes. Nuk vin dot ambulanca se janë rrugët e bllokuara. Janë afër shkollës dhe banesave oficianat. Banorët kanë interesa personale por rruga nuk privatizohet. Kam financuar për ndricimin dhe rrugën me beton para shkollës. Problemi i dyte janë parkimet e lira. Jemi biznese dhe kemi të drejtën të parkojmë. Problem i trete është nevoja për investim të një këndi sportiv për fëmijet ose parku.

Irena Toshkallari: Do e shikojmë kërkesën për këndin sportiv. Nëse nuk çënohet projekti. Parkimet kanë procedurë të përcaktuar me pagesë për biznesin. Ofcinat dhe lavazhot do e kalojme të Policia Bashkiake dhe drejtoria. Grupi do vij në terren. Mos të shkelet hapsira publike. Strukturat përgjegjëse do verifikojnë.

Qytetari: Mbaj brenda ofcinës dhe makinat. Këto biznese janë jashtë qytetit.

Qytetar: Janë kanalizimet te shkolla 15 Tetori dhe Karabash. S'kemi ujë. Mbas shkollës Teli Ndini. Rruga e shkollës është e rezikshme për fëmijët. Të bëhet asfalti dhe ajo copë rruge.

Qytetar: Llambat, nuk kish vinc bashkia ti vendoste.

Irena Toshkallari: Kërkesat tuaja që mund të përfshihen në projekt do i shikojmë, për shqetësimet e tjera që ngritët do të dërgojmë në terren grupet përkatëse

Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik

Albana Naçi